



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 1.

Prishtinë, më 24.12.2014 në orën 11:00.

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Xhavit Haliti, Vjosa Osmani, Valdete Bajrami, Rrustem Mustafa, Arben Gashi, Luljeta Veselaj - Gutaj, Ilir Deda dhe Kujtim Paçaku

Munguan Blerim Shala dhe Slllobodan Petroviq.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija, kryetare e Komisionit.

Rendi i Ditës

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Mbledhja konstituive e Komisionit;**
- 3. Të ndryshme .**

Kryesuesja iu uroj mirëseardhje anëtarëve të komisionit dhe konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua si i tillë.

- 2. Mbledhja konstituive e Komisionit;**

Kryetarja: gjatë mbledhjes konstituive i bëri një vështrim fushëveprimtarisë së Komisionit duke i paraqitur të gjitha pikat e saj dhe pasi që në përbërje të komisionit ka anëtarë që kanë qenë anëtarë të Komisionit në mandatin e kaluar, komisioni ka një eksperiencë të duhur dhe beson se do të funksionoj mirë dhe më pas e hapi debatin.

Ilir Deda: konsideron se duhet të ripërtërihet fushëveprimtaria e Komisionit, sepse këtu përmenden disa institucione që tani nuk ekzistojnë më, si Zyra Ndërkombëtare Civile , pastaj Zyrës ndërlidhëse të Komisionit Evropian, i është ndërruar emërtimi, pra duhet të specifikohen saktë me cilat institucione ndërkombëtare bashkëpunojmë dhe të jenë të harmonizuara me kohën në të cilën jemi dhe të kemi emërtimin e saktë të institucioneve .

Arben Gashi: tha se kjo fushëveprimtari është nxjerr nga Rregullorja e punës së Kuvendit andaj kur të ndryshohet Rregullorja, duhet të ndryshohet edhe fushëveprimtaria.

Xhavit Haliti: duke marrë fjalën, propozoi që Vjosa Osmani si ish- kryetare e këtij Komisioni të njoftojë lidhur me punën e bërë gjatë mandatit të kaluar.

Vjosa Osmani: tha se i vjen mirë që ky Komision udhëhiqet nga një grua dhe nënkryetare ka një grua. Lidhur me punën e Komisionit në mandatin e kaluar, ajo tha se ky komision ka pas mjaft sfida në kuptimin pozitiv dhe ka qenë komisioni vetëm ndoshta që ka pas harmoni të plotë, pavarësisht përkatësisë partiake sepse agjenda evropiane është konsideruar si agjendë e interesit nacional dhe pavarësisht mospajtimeve kemi arrit t'i tejkalojmë ato dhe të gjejmë një gjuhë të kompromisit në shumicën e dokumenteve që kanë dalë nga ky komision.

Sa i përket fushëveprimtarisë, ajo tha se Komisioni pati bërë disa ndryshime në praktikë, por shtoi se nuk lejohet të ndryshohet fushëveprimtaria, pa u ndryshuar rregullorja e punës së Kuvendit.

Në fushëveprimtari i patëm fshirë institucionet që nuk ekzistojnë dhe janë ndryshuar ato të cilave iu është ndryshuar emërtimi. Ajo sqaroi pse Këshilli i Evropës që nuk është pjesë e BE-së, qëllimisht ka mbet në këtë komision e jo në Komisionin për punë të jashtme, sepse asnjë shtet anëtar i BE-së nuk mund të hyjë në BE, pa qenë paraprakisht anëtar i Këshillit të Evropës. Është kriter i pashkruar dhe kur bëhet vlerësimi i kriterëve në fushën e të drejtave të njeriut, zakonisht BE-ja i shikon raportet që një shtet i ka në Këshillin e Evropës. Prandaj, në këtë komision ka mbet si fushëveprimtari shumë specifike, natyrisht nuk është institucion i BE-së por fushëveprimtaria e këtij komisioni shkon përtej BE-së, madje edhe delegacioni i përhershëm në Asambleenë parlamentare të Këshillit të Evropës nga Kuvendi i Kosovës gjithnjë e ka përfshirë një anëtar nga ky komision, sepse vetëm ne e kemi në fushëveprimtarinë tonë procesin e anëtarësimit dhe bashkëpunimit me Këshillin e Evropës dhe gjithnjë për këtë specifike, ministri i punëve të jashtme ka ardhur të raportojë në Komision

Çështje tjetër që e patëm diskutuar shumë, së paku në praktikë, është çështja e harmonizimit të legjislacionit me Acquis communitare dhe përafrimit, janë dy koncepte të ndryshme sepse harmonizimi nënkupton që ligjet tona duhet të jenë gati në përputhshmëri të plot me Acquis communitare, kurse përafrimi është në një nivel pak më të ulët. Qeveria ka për obligim të bëjë përafrim, kurse nga ne është kërkuar harmonizim dhe ne gjithnjë e kemi pas një standard më të lartë sepse nuk jemi bazuar vetëm në raportin e Qeverisë, por e kemi shqyrtuar edhe Projektligjin dhe amendamentet e komisioneve funksionale. .

Sa i përket raportimit të ministrave, ajo tha se ky komision është ndër komisionet që ka numrin më të madh të ministrave që raportojnë, sepse edhe Raporti i Progresit i Komisionit Evropian edhe dokumentet tjera, na obligojnë që ta mbulojmë një fushë më të gjerë. Ne në mandatin e kaluar patëm marrë iniciativë ta thërrasim kryeministrin në Komision që të raportojë për një aspekt të caktuar, të flasë për lidhshmërinë në mes të dialogut me Serbinë dhe perspektivën evropiane të Kosovës, për të shikuar se si një proces po e ndihmon tjetrin. Nuk kemi arrit ta bëjmë në mandatin e kaluar sepse është bërë shpërbërja e Kuvendit, por ka pasur konsensus të plot lidhur me këtë.

Lidhur me planin e punës të këtij komisioni, ajo tha se kemi hartuar një plan mjaft ambicioz dhe është hartuar në bashkëpunim me institucionet evropiane në Kosovë dhe është mirëpritur jashtëzakonisht mirë, gjë që e ka bërë këtë komision një ndër më aktivët në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Propozoj që ky plan i punës të shërbejë si vazhdimësi për hartimin e planit të sivjetmë sepse shumë punë të filluara patën mbetur në gjysmë, për shkak të ndërprerjes së mandatit, theksoi Vjosa Osmani.

Kryetarja: tha se e kam shikuar planin e punës dhe mu duk një plan i mirë dhe gjithëpërfshirës, pasi që plani legjislativ i Qeverisë ende nuk ka mbërrirë në Kuvend, pa të cilin nuk mund ta hartojmë planin ton të punës, por kjo nuk do të duhej që të na pengojë që ta mbajmë një mbledhje javën e ardhshme dhe të fillojmë të mendojmë për planin e Komisionit për vitin e ardhshëm.

Khavit Haliti: theksoi se një ndër vërejtjet e përhershme të Komisionit Evropian ishte pavarësia buxhetore e Kuvendit të Kosovës nga buxheti i miratuar në Qeveri, prandaj, pasi që në komision janë të përfaqësuar të gjitha grupet parlamentare dhe partitë, insistoj që të diskutojmë këtë çështje në grupet parlamentare dhe komisionet e tjera, me qëllim ta realizojmë gjatë kësaj legjislature sepse për këtë vit nuk ka gjasë, por gjatë rishikimit të buxhetit dhe në përputhje me nismën për ta bërë Ligjin për parlamentin, të punojmë që ta kalojmë këtë çështje, sepse Kuvendit do ti lehtësohen punët me varësinë nga Qeveria dhe mekanizmat e Qeverisë. Shpeshherë me propozime jemi kundërshtuar nga opinioni dhe duhet vërtet t'i shohim jo privilegjet, por të drejtat dhe mundësitë edhe të deputetëve dhe administratës së Kuvendit, sepse jemi në legjislaturën e pestë dhe asnjë punonjës i administratës së Kuvendit nuk është i siguar, përkundër ndërmarrjeve publike që i kanë të siguar. E konsideroj si domosdoshmëri për secilin dikaster të shtetit në veçanti, por edhe obliguese për dikasteret private, që punonjësit e tyre të sigurohen, theksoi Haliti.

Vjosa Osmani: tha se tek çështja e Këshillit të Evropës, i propozoj kryetares së Komisionit që ti shkruajë kryetarit të Kuvendit, i cili do ta emërojë delegacionin e përhershëm në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe një nga anëtarët domosdo të jetë nga ky komision, sepse në fushëveprimtarinë e vet e ka dhe është i vetmi komision që ka njohuri se deri ku ka ardhur procesi dhe kemi qenë të përfaqësuar në delegacionin të zgjedhur nga ish- kryetari i Kuvendit.

Ilir Deda: propozoi që për të gjithë anëtarët e Komisionit të bëhet një pako me dokumente që duhen për punë, duke filluar prej planit të Veprimit për MSA-në e deri te buxheti i komisionit që do ta marrin vesh javën e ardhshme, sepse tha ky procesi i integritetit evropian tejkalon edhe Kuvendin dhe do të ishte mirë që në sfera të ndryshme të konsultojmë ekspertë, të cilët ekzistojnë në Kosovë për këtë fushë. Ai më pas u ndërlidh me propozimin e parafolësës, pasi tha se ky Komision merret me Këshillin e Evropës, andaj edhe anëtarët e delegacionit duhet të jenë nga ky komision, njëri nga pozita e tjetri nga opozita dhe para fillimit të punës me mbledhje të rregullta, paraprakisht ta shohim bashkërisht, çfarë plani real të punës mund ta kemi, tha Deda.

Valdete Bajrami: lidhur me planin e punës së Komisionit, tha se duhet t'i referohemi planit të punës së komisionit të kaluar, pasi që është bërë shpërndarja e Kuvendit dhe shumë punë kanë mbetur pa u kryer dhe t'i caktojmë si prioritet punët e papërfunduara dhe ta hartojmë pastaj një plan tjetër me pika të caktuara.

Vjosa Osmani: tha se do të ishte mirë që atë plan ta marrim si bazë dhe të ndryshojmë çka do që ka nevojë sepse ka disa ligje që i janë kthyer Qeverisë. Ne tha ajo e kemi pas në plan Ligjin për përgjimet, që ka qenë në diskutim a me i taku Ministrisë së Integritetit apo Ministrisë së Punëve të Brendshme, por kur erdhi në Kuvend erdhi direkt te ne, e jo te Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri dhe ata janë ankuar pse nuk i është dërguar atyre, por arsyeja ka qenë se

ka qenë një projektligj shumë i ndjeshëm, në momentin e parë kur është hartuar, ka qenë në shpërputhje totale me standardet e Acquisit komunitare dhe është kërkuar që draftin e dytë ta hartojë Ministria e Integritimit dhe ka ardhur pastaj drejtpërdrejt te ne, por pas shpërbërjes është kthyer prapë në qeveri. Plani i kaluar i punës mund të shërbejë si bazë, sepse plani i ri i punës varet prej agjendës legislative, por nuk besoj se do të ketë ndryshime të mëdha, tha Osmani.

Arben Gashi: dha disa sqarime procedurale duke thënë se në Kuvendin e Kosovës nuk ka asnjë Projektligj përveç atij të buxhetit sepse të gjitha projektligjet që procedohen në Kuvend dhe sipas rregullores i kthehen Qeverisë

Pastaj Plani i punës së Komisionit duhet të përshtatet me planin e punës së Kuvendit, me agjendë legislative të Kuvendit, në mënyrë që mos të kemi përplasje me agjendën legislative. Agjenda legislative gjithmonë është propozuar prej Qeverisë, e pastaj deputetët kanë propozuar se çka mund të ndryshohet dhe është aprovuar në seancë, kështu që ne mos të aprovojmë një plan të punës pa agjendë legislative dhe t'i harmonizojmë planet që do t'i bëjmë në mënyrë që mos të kemi planifikime joreale prej neve, natyrisht të merret edhe që plani i punës së Komisionit të kaluar si pikë orientuese, por pika kryesore e referencës është agjenda legislative e Kuvendit dhe mbi bazën e saj të shohim se si mund të japim kontribut ekstra ne si komision edhe në aspektin e raporteve me institucionet evropiane, por edhe në aspektin e kontrollit parlamentar në institucionet e Kosovës dhe se çka po bëhet në drejtimin e progresit evropian.

Ne nuk mund të jemi faktori kryesor i agjendës legislative, por jemi pjesë e rëndësishme e agjendës legislative që duhet ta inkorporojmë në komisionin tonë, tha Gashi.

Rrustem Mustafa: tha se informatat e marra rreth planit të punës na duhet sigurimi i kontinuitetit të punës, por tërhoqi vërejtjen për lëvizjen e njerëzve tanë jashtë vendit dhe pasi jemi në një fazë jo normale, ne duhet ta caktojmë një prioritet, normalizimin e situatës, sepse pa normalizim nuk mund të vijmë te integrimi. Neve na duhet normalizimi i mekanizimit institucional, propozimi për krijimin e task forces nga ana e ministrit të Ministrisë së Integritimit Evropian është diçka e kotë dhe nuk na duhet, sepse sa herë krijohen komisione edhe task forca është vetëm sa me e shty, ne duhet me nda dikë nga komisioni që ka metodë, që do të sugjerojë dhe të angazhohemi për normalizimin e disa proceseve që i paraprinë integritimit. Ne jemi komision i integritimit dhe besoj që plani i punës që ka mbet në gjysmë, duke i fuzionuar me interesat që ne i shohim këtu, besojmë që do ta vendosim në binarë punën e duhur..

Xhavit Haliti: u ndërlidh lidhur me ligjet në legjislaturën e kaluar dhe kthimin e tyre në Qeveri, ato të cilat kanë mbetur pa u shqyrtua, theksoi se do të ketë debat për ligjin për përgjime. Ne nuk kemi nevojë ta zbulojmë ujin e nxehtë si Kosovë. Secili vend i BE-së e ka ligjin e vet të përgjimeve dhe në përputhje me këtë ne mund ta marrim një model të një shteti që e ka ligjin e mirë sa i përket kësaj, duke përfshi pamundësinë e të drejtave të njeriut dhe keqpërdorimin politik sa i përket përgjimeve dhe pa mundësinë për të krijuar polici politike, e cila njihet opozicionin politik dhe kjo do të ishte e tëra sa i përket kësaj. Për mua shqetësuese, tha Haliti, është lënia e verifikimit të figurave ose të administratës në përgjithësi në dikasteret e veçanta në duar të AKI-së. Sa jam në dijeni, shpeshherë ka pasur përplasje në mes të AKI-së dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme rreth verifikimit të figurave ose punonjësve të policisë ose punonjësve të tjerë, të cilët kanë konkurruar në detyra të veçanta, për të cilat duhet kaluar ndonjë test i verifikimit.

Kujtim Paçaku: si deputet i ri në këtë legjislaturë e gëzon fakti që në këtë komision po flitet pa ngjyrimet politike. Paçaku shpreson që do të kemi fuqi të shtyjme çdo sfidë në rend të parë duke mbrojtur interesat e shtetit të Kosovës dhe pa i anashkaluar interesat e komunitetit pakicë rom, të cilin ai e përfaqëson dhe tha se kam bindje të fortë që do të më përkrahni në këtë drejtim, sepse jam betuar para komunitetit tim dhe do të më ndihmoni kur është në pyetje interesi i komunitetit rom, në kuadër të shtetit dhe Evropës.

Luljeta Veselaj –Gutaj: tha se i bashkëngjitëm mendimit të parafolësve se ne duhet të kemi njohuri si komision rreth asaj se çka është punuar dhe ta kemi planin e punës dhe të dimë se deri ku është arritur që të kemi mundësi edhe për ndërhyrje dhe të vazhdojmë aty ku nuk ka nevojë për ndërhyrje. Uroj punë të mbarë si komision dhe unë me të gjitha përgatitjet e mia profesionale dhe intelektuale do ta japë kontributin tim.

Të ndryshme .

Kryetarja: kërkoi nga anëtarët që për mbajtjen e mbledhjeve të Komisionit, të caktohet dita dhe ora e mbajtjes së mbledhjeve të rregullta. Propozoj ditën e hënë ose ditën e martë, dhe pas diskutimeve, anëtarët u pajtuan që të martën prej orën 11:00, të mbahen mbledhjet e rregullta të komisionit .

Pas diskutimeve Kryesuesja nxori këto përfundime:

1. Kërkoj nga stafi që secilit ti dërgohet nga një pako me dokumente, duke filluar nga plani i punës dhe të gjitha dokumentet tjera relevante për këtë komision;
2. Mbledhja e radhës për shqyrtimin e Projekt buxhetit për vitin 2015 të mbahet të premtën pas dite sepse priten amendamentet e Komisionit Funksional;
3. Për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të Komisionit, u caktua dita e martë, në orën 11:00.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**Kryetare e Komisionit
Znj.Teuta Sahatqija**
